

RELACION JOTEKNIK

ALMODA SHPK

7.12.n

Veprimtaria e lyerjes/veshjes aplikuar ne materiale lekure

Maj 2023

Ekspert mjedisi: ELVIS XHAFERRI



PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Qellimi i projektit

Subjekti ALMODA Sh.p.k është i regjistruar ne organet tatimore me nr identifikimi NIPT: **L32416001D** me vendndodhje Kraste, Kruje, Qarku Durres, Godine e kompnuar 3 kate, kati i dyte me Numër Pasurie 4998, Zona Kadastrale 8622. Subjekti "ALMODA" Sh.p.k do te aplikojë do te aplikojë per Leje Mjedisi tipi B.

Klasifikimi bazuar ne ligjin 10 448

Veprimtari te tjera qe përfshijnë përdorimi e solventeve 7.12.n Veprimtaria e lyerjes/veshjes aplikuar ne materiale lekure, me kapacitet konsumi solventesh me te madh se 10 ton/vit

Objektivat e aktivitetit

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

Vendndodhja dhe karakteristikat fizike te projektit.

- Instalimi dhe aktivitetet e tij
- Operatori "ALMODA" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin e Veprimtaria e lyerjes/veshjes aplikuar ne materiale lekure. Vendi ku do te ushtrohet aktiviteti eshte me vendndodhje Kraste, Kruje, Qarku Durres, Godine e kompnuar 3 kate, kati i dyte me Numër Pasurie 4998, Zona Kadastrale 8622.
- Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

Lendet e para qe perdoren jane lekura ,materiale plastike ,tokeza metalike te cilat vijne te gatshme sipas madhësisë ,modelit dhe konfiguracionit te artikullit qe do te prodhohet.

Keto materiale vijne nga Italia te gatshme ,te ndara ne paketime te vecanta dhe ketu nuk i behet perpunim tjetër pervec qepjes dhe ngjitjes sipas modelit te kerkuar.

Produktet perfundimtare jane aksesore qe perdoren ne veshje ose kepuce si tokeza,fjongo lekure,rripa beli dhe cante ,logo te ndryshme qe ngjiten ne kepuce dhe canta.

Makinerite kryesore te punes jane :

- Makinat Qepese
- Makinat prerese,
- Furre elektrike,
- Bangat e punes,
- Furre per ngjitje,

Zhvillimi i këtij aktiviteti ka përdorim të lemdeve të lara si lekure, materiale plastike dhe tokëza metalike. Ne kete aktivitet uji nuk eshte pjese e procesit teknologjik. Ai do te perdoret vetem per nyjet sanitare ose pastrime te tjera. Gjithashtu edhe do te shkarkohet ne rrjetin e kanalizimeve te zones. Energjia elektrike do te merret nga rrjeti i zones ne baze te kontrates qe operatori posedon.

- **Burimet e shkarkimeve nga instalimi**

Shkarkime ne ajer - Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi shkarkime ne ajer, shkarkimet e vetme ne ajer mund te vine nga makinat e transportit te lendes se pare. Kontrolli i shkarkime ne ajer siguron nje mjedis me te sigurte per pune.

Shkarkime ne ujera - Ujerat e nyjeve sanitare do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Shkarkime ne toke - Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete shkarkime ne toke, mbetjet te cilat do te gjenerohen si pasoje e aktivitetit te konsumit te punonjesve do te grumbullohen dhe do te depozitohen fillimisht ne kontenier te mbyllur ne ambientet e aktivitetit dhe ne fund te cdo dite pune do te largohen per ne vendet e perbashkta te administruara nga Pushteti Vendor, ndersa mbetje nga procesi teknologjik do te menaxhohen nga subjekte te licensuara.

Gjenerimi i zhurmave - Zhvillimi i aktivitetit mund te ndikojë ne nje rritje shume te lehte te zhurmes per mos thene qe do jete paperfillshme.

- **Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes**

Vendi i zhvillimit te aktivitetit disponon te gjithe kapacitetin dhe hapesiren per te operuar pa krijuar ndotje dhe shqetesime.

- **Natyrë dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis**

Shkarkimet qe vijne si pasoje e zhvillimit te aktivitetit nuk mund te konsiderohen ndotese. Keto shkarkime do te jene normale, brenda legjislacionit aktual ne fuqi. Operatori do te marre masa te vazhdueshme per minimizimin sa me te madh te tyre, duke bere edhe monitorimet perkatese per komponentet e cituar ne Anekset e mesiperme.

NDIKIME NEGATIVE NE MJEDIS
Rrezatimi Jonizues
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.
Vibracionet
Funksionimi i aktivitetit nuk gjeneron vibrime.
Ndikimet ne popullsi
Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullise se rajonit ku zhvillohet aktiviteti. Gjate funksionimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullise se rajonit.
Ndikimet ne toke
Aktiviteti nuk gjeneron shkarkime ne toke.
Mbetjet e ngurta
Mbetjet qe dalin nga procesi i punes do te menaxhohen nepermjet subjekteve te licensuara per teheqjen e tyre. Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat i aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga Pushteti Vendor.
Ndikimet ne ajer
Referuar natyres se aktivitetit mund te kemi ndikime negative ne ajer. Clirime minimale ne ajer si pasoje eaktivitetit te makinave te transportit te lendes se pare
Ndikimet ne ujera
Funksionimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne ujera. Ne ujera do te kemi vetem shkarkimin nga nyjet sanitare te cilat do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.
Ndikimet ne klime
Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.
Ndikimet ne floren dhe faunen
Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane dhe nuk mund te analizojme ndikime ne flore dhe faune. Operatori do te shtojte siperfaqet e gjelberta per nje pamje vizuale me te kenaqshme per syrin dhe per te mirat ne pikepamjen mjedisore.
Ndikimet nga zhurmat
Zona ne te cilen zhvillohet aktiviteti eshte ne afërsi te rrugës Fushe Kruje – Kruje . Per kete arsye zhurma eshte prezente ne cdo ore te dites nga qarkullimi rrugor i makinave. Nga funksionimi i aktivitetit nuk pritet te kete rritje te nivelit te zhurmave, aq me teper ndikime negative ne kete prizem.
Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin
Infrastruktura ne te gjithë perimetrin e aktivitetit eshte e shtruar gjithashtu edhe rruga kryesore qe kalon prane aktivitetit. Nuk pritet qe te kete ndikime negative apo ndryshime te infrastruktures.
Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura
Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar kete aktivitet.
Ndikime ne rrjetin hidrografik
Natyra e aktivitetit nuk kerkon perdorim te ujit. Perdorimi i ujit qe do perdoret per nyjet sanitare do te kryhet nga rrjeti publik dhe do te shkarkohet ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Ndikimi social-ekonomik

Me operimin e këtij aktiviteti pritet të ketë një impakt pozitiv në ekonominë e vendit, në aspektin e punësimit.
--

- **Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme**
 1. Teknikat më të mira të disponueshme " (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre të veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve të percaktuara për të parandaluar dhe ku nuk është e praktikueshme, në përgjithësi për të reduktuar emetimet dhe ndikimin e tyre në mjedis në tërësi;
 2. 'Teknika' përfshin të dyja si teknologjinë e përdorur dhe mënyrën në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar.
 3. Teknikat më të mira të disponueshme' do të thotë ato që janë të zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomikisht dhe teknikisht të zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur ose prodhuar teknikat brenda territorit të Pales në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft të lejueshme për operatorin;
 4. Me të mirë ' do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi. Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi, ose në raste të veçanta faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot më të mundshme dhe përfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit:
 5. Proceset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qenë provuar me sukses në një shkallë industriale;
 6. Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të të kuptuarit;
 7. Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;
 8. Datat e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;
 9. Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;
 10. Konsumi dhe natyra e lëndëve (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë;
 11. Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;
 12. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin. Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore

- **Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur**

Ne vendndodhje është ngritur godina për zhvillimin e aktivitetit, kjo sepse është në një zonë e frekuentuar e cila sa vjen dhe zhvillohet me shumë. Për këtë arsye edhe fitimet ekonomike arrijnë targetin që kompania i ka vendosur vetes.

- **Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme)**

1. Grumbullimi i mbetjeve urbane në konteniere të posaçem dhe hermetik për të evituar aromat epakendshme sidomos në periudhë reshjesh dhe thatësire.
2. Diferencimi i mbetjeve të ardhura nga aktiviteti i punonjësve që në burim në kosha me ngjyra.
3. Depozitimi periodik në vendet e përbashkëta që administrohen dhe terhiqen nga Njësia e QeverisjesVendore.
4. Mbajtja e regjistrave për sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe depozitimi i tyre në harqe kohore 6-mujore në instancat shtetërore përkatëse.
5. Menaxhimi i mbetjeve që dalin nga procesi teknologjik nëpërmjet subjekteve të licencuara.

- **Masat për përdorimin efiçent të energjisë**

1. Auditimi vjetor, nga auditues në procese për evidentimin e përdorimit eficient të energjisë.
2. Vlerësimi nga menaxheri i energjisë për gjendjen e impiantit dhe vlerësimin e pjesëve me të reja.
3. Vendosja apo zëvendësimi i pajisjeve jo më vonë se 2 vjet pas përfundimeve të dalta nga Audituesi i Energjisë.

- **Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:**

Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre

Detyrimet e punëdhënësit

- Punëdhënësi vetë ose personi përgjegjës që ka ngarkuar, duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:
- Specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet që do të përdoren.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës, ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajturi shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Përveç sa më sipër punëdhenësi ka detyrë që:

- Të sigurojë për çdo rast ndihmen e parë mjeksore.
- Të vendos në territorin e instalimit, në vende të dukshme tabelat me rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Të bëjë instruktimin periodik të punonjësve dhe të plotësoj për këtë qëllim formularët bazë të përcaktuar në rregulloret e sigurimit teknik.

Detyrimet e punëmarrësit

- Të njoh mirë procesin e punës dhe makinerit apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojtë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masa duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë

Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Natyra e nje aktiviteti te tille preket nga nderprerje sezonale. Per kete arsye nderprerjet definitive do te shoqerohen me zbatimin e planit te cmontimit te instalimit dhe zbatimin e plote te planit te rehabilitimit te mjedisit postfungsionim. Gjithashtu per nderprerje te tilla si pasoje e avarive qe shoqerohen me ndotje te tipeve te ndryshme duhet te njoftohen instancat shtetetore. Megjithate aktivitetit nuk parashikon nderpreje apo mbyllje te aktivitetit.

- Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Qëllimet e monitorimit mjedisor: Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Eshte që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e prodhimit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga faktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar

Monitorimi i Planifikuar	
Monitorimi i parametrevë mjedisore (ajer dhe zhurme)	Cdo 6 muaj
Monitorimi i trajnimeve te stafit ne raste emergjente	Cdo 6 muaj-1 vit
Monitorimi i gjendjes mekanike te pajisjeve operuese	Cdo dite nga punonjesi i impiantit Cdo 1 muaj nga mekanike te posacem
Monitorimi i perdorimit eficient te energjise	Cdo 1 vit nga kompaniadhe cdo 2 vjet nga Audituesi i Energjise

Planvendosja e "ALMODA" Sh.p.k



Vendndodhja e "ALMODA" sh.p.k

Nr.	E	N
1	4397863.94	4596921.67
2	4397883.47	4596936.94
3	4397893.92	4596925.70
4	4397874.84	4596909.11

Koordinatat ne Gauss- Kruger te vendndodhjes